



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 6

Tiranë – E premte, 22 janar 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i Kuvendit nr. 3, datë 15.1.2016	Për delegimin e kompetencave.....	329
Dekret i Presidentit nr. 9404, datë 19.01.2016	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	329
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 20.1.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.....	329
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 20.1.2016	Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore.....	330
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 20.1.2016	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016.....	335

**URDHËR****Nr. 3, datë 15.1.2016****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit, për Kuvendin e Shqipërisë, nëpunësit autorizues, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Kuvendin e Shqipërisë, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla për procedurat e prokurimit mbi vlerën e ulët monetare. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për Kuvendin e Shqipërisë, Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Administrativ të këtij institucioni, znj. Etleva Zeqo, për procedurat e prokurimit nën vlerën e ulët monetare.

3. Kompetencat e deleguara të titullarit të Kuvendit të Shqipërisë, do të ushtrohen për periudhën, nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31.12.2016.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

DEKRET**Nr. 9404, datë 19.01.2016****PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë

shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë, të tyre personave të mëposhtëm:

1. Monika Sali Mëziri
2. Servete Lulzim Kanapari
3. Denisa Sihat König (Gjomemo)
4. Suela Nazmi Qeraj
5. Senad Hajri Ceni
6. Ilirjan Mehmet Berisha
7. Redjan Gëzim Tari
8. Tahir Zenel Burlo
9. Elvira Riza Burlo (Kanani)
10. Jurgen Tahir Burlo
11. Leonidha (Lulzim) Jani Mishtari
12. Izet Vehbi Salih

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM**Nr. 15, datë 20.1.2016****PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, programi “Shërbime qeveritare”, të shtohet fondi prej 178 636 736 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, për rikonstruksionin e pjesshëm të Pallatit të Kongreseve, në Tiranë,



në kuadër të organizimit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, në datat 27–30 maj 2016, në Tiranë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit i vitit 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 23, datë 20.1.2016

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHE PËR VITIN 2016 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore është 1 723 veta, sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Përjashtimisht, për punonjësit e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), Drejtorisë së Dëmshpërblimit të ish-të Përndjekurve Politikë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave dhe për praktikantët e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, të paraqitur në lidhjen nr. 2 të sipërpërmendur, nuk zbatohet pika 3, e vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

3. Përjashtimisht, pagesa për mjekët e kontraktuar të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i referohet vendimit përkatës të pagave për sistemin shëndetësor dhe pagesa për punonjësit e

kontraktuar për Qendrën e Transferimit të Teknologjisë, Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve dhe Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për shkak të veçorisë së punës, përlloraget sipas volumit të punës së kryer dhe kjo pagesë kryhet sipas preventivit përkatës.

4. Përjashtimisht, punonjësit, të cilët merren me anketime të ndryshme të Institutit të Statistikave, instruktorët e qendrave të formimit profesional, si dhe mësuesit në dispozicion në arsimin parauniversitar dhe atë profesional, nuk përfshihen në këtë vendim. Miratimi i numrit të këtyre punonjësve, afatet kohore dhe specifikime të tjera për kontraktimin me kohë të pjesshme të tyre bëhen sipas udhëzimit të përbashkët të institucionit qendror përgjegjës dhe Ministrisë së Financave.

5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi fillojnë pas hyrjes në fuqi të vendimit. Përjashtimisht, për pozicionet e kontraktuara për periudhën kohore vjetore, efektet financiare fillojnë në datën 1 janar 2016 dhe pagesa e muajit dhjetor kryhet në fund të këtij muaji, me fondet e miratuara për vitin 2016.

6. Efektet financiare për punonjësit e kontraktuar përballohen nga shpenzimet korrente të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2016 të njërive të qeverisjes qendrore. Për punonjësit e kontraktuar sipas pikës 3, të vendimit, për punonjësit e Shtëpisë së Pushimit Durrës (të MPB-së), Shtëpisë së Pushimit të SHISH-it dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, efektet financiare përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit, për punonjësit e kontraktuar për ALUIZNI-n dhe qendrat e formimit profesional përballohen pjesërisht nga të ardhurat dhe pjesërisht nga fondet buxhetore të miratuara për vitin 2016.

7. Ngarkohen ministritë dhe institucionet sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
02	Kuvendi	11			
	<i>Sektori i Botimeve Parlamentare</i>	2	Specialist redaktimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtërimi i Marrëdhënieve me Publikun</i>	2	Specialist	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Sektori i Teknikës Audio-Video</i>	1	Specialist audio-video	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Sektori për Dizhitalizimin e Fondit Arkivor</i>	1	Operator	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Sektori i Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar</i>	1	Punonjës protokoli	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Shtëimit dhe Mirëmbajtjes</i>	2	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtërimi i Financës dhe Buxhetit</i>	2	Inventarizues	6 orë/ditë	mars-prill, shtator-dhjetor
03	Kryeministria	33			
	<i>Aparati i Kryeministrit</i>	24	Operator	6 orë/ ditë	vjetore
	<i>Aparati i Kryeministrit</i>	9	Specialistë	6 orë/ ditë	vjetore
04	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	22			
	<i>Aparati</i>	2	Punonjës pastrimi	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati</i>	1	Nëpunës roje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>ATRAKO</i>	1	Punonjës pastrimi	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra Kombëtare e Licencimit</i>	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra Kombëtare e Regjistrimit</i>	2	Punonjës arkiv-protokoli	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra Kombëtare e Regjistrimit</i>	1	Punonjës teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra Kombëtare e Regjistrimit</i>	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra Kombëtare e Regjistrimit</i>	1	Punonjës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit</i>	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve</i>	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme Patentave, Markave</i>	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme Patentave, Markave</i>	1	Operatore	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, (Qendër)</i>	2	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, (Qendrat Rajonale)</i>	3	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Ajencia Kombëtare e Turizmit</i>	1	Roje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Ajencia Kombëtare e Turizmit</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Ajencia Kombëtare e Turizmit</i>	1	Punonjës pastrimi	6 orë/ditë	vjetore
05	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	131			
	<i>QTTB Vlorë</i>	14	Punëtor fushe/mirëmbajtës		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Vlorë</i>	4	Roje baza eksperimentale		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Lushnjë</i>	14	Punëtor fushe		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Lushnjë</i>	4	Punëtor		vetëm periudha pik
	<i>QTTB Korçë</i>	8	Punonjës blegtorie		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Korçë</i>	6	Roje objekti		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Korçë</i>	9	Punëtor fushe		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Korçë</i>	5	Teknik i mesëm		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Korçë</i>	4	Punëtor		vetëm periudha pik
	<i>QTTB Shkodër</i>	6	Roje baza eksperimentale (nëpunës informacioni)		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Shkodër</i>	6	Punëtor fushe		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Shkodër</i>	3	Punëtor		vetëm periudha pik
	<i>QTTB Fushë-Kryjë</i>	5	Punëtor fushe		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Fushë-Kryjë</i>	6	Roje baza eksperimentale (nëpunës informacioni)		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Fushë-Kryjë</i>	10	Teknik i mesëm		vjetor - sipas preventivit
	<i>QTTB Fushë-Kryjë</i>	2	Punëtor		vetëm periudha pik
	<i>Ajencia Kombëtare e Duhan Cigareve</i>	12	Punëtor fushe		vjetor - sipas preventivit
	<i>Ajencia Kombëtare e Duhan Cigareve</i>	3	Teknik i mesëm		vjetor - sipas preventivit
	<i>Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve</i>	4	Teknik i mesëm		vjetor - sipas preventivit
	<i>Drejtoria e Shtëpimeve të Peshkimit dhe Akuatulturës</i>	3	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Shtëpimeve të Peshkimit dhe Akuatulturës</i>	3	Punëtorë mirëmbajtës	6 orë/ditë	vjetore
06	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	12			
	<i>Aparati</i>	5	Punonjës protokoli/arkivist	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Instituti i Transportit</i>	1	Punëtor pastrimi	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor</i>	1	Punëtor pastrimi	3 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve</i>	1	Punëtor pastrimi	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve</i>	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme Detare</i>	1	Specialist kapitenerie	8 orë/ditë	qershor-shtator
	<i>Drejtoria e Përgjithshme Detare</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme Detare</i>	1	Roje	6 orë/ditë	vjetore
10	Ministria e Financave	575			
	<i>Aparati i Ministrisë (Dr. e Drejtimit të Pronës Publike)</i>	1	Punonjës protokoli/arkivist	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë, CFCEU</i>	1	Punonjës protokoli/arkivist	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë, CFCEU</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Specialist arkivist	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	2	Specialist	8 orë/ditë	6-mujore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	4	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Dëmtshpërblimit të Ish-të Përndjekurve Politikë</i>	4	Specialist	8 orë/ditë	vjetore
	<i>Ajencia Administrimit të Pasurive të Sekuestruara</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Degët e Thesarit</i>	7	Sanitar	3 orë/ditë	vjetore



<i>Doga e Thesari Tiranë</i>	3	Nëpunës informacioni/roje	6 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave</i>	5	Specialist	8 orë/ditë	vjetore
<i>Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave</i>	4	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Qafë Thanë</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Qafë Thanë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Elbasan</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Durrës</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Durrës</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Kakavijë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Tri Urat Përmet</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Shkodër</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Shkodër</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Tiranë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Vlorë</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Bllatë</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Dogana Korçë</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Aparati Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve</i>	2	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Aparati Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve</i>	500	Punonjës mirëmbajtjeje	8 orë/ditë	6-muaj
<i>Drejtoria Rajonale Tatim TM Tiranë</i>	3	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Berat</i>	1	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Dibër</i>	1	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Dibër</i>	1	Operator	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Durrës</i>	2	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Durrës</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Elbasan</i>	2	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Fier</i>	2	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Gjirokastrë</i>	1	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Korçë</i>	1	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Kukës</i>	1	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Lezhë</i>	1	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Sarandë</i>	2	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Shkodër</i>	2	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Vlorë</i>	1	Operator	4 orë/ditë	vjetore
<i>Drejtoria Rajonale Tatim Vlorë</i>	1	Punonjës protokolli/arkivist	4 orë/ditë	vjetore
11 Ministria e Arsimit dhe Sportit	42			
Drejtoritë rajonale arsimore	13	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Zyrat rajonale arsimore	25	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Agjencia Kombëtare e Provimeve	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Inspektorati Shtetëror i Arsimit	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Agjencia Publike Akreditimit të Arsimit të Lartë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Agjencia e Shërbimeve të Sportit	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
12 Ministria e Kulturës	38			
Aparati	1	Lulishtar	6 orë/ditë	vjetore
Aparati	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
Aparati	2	Teknik i mesëm	4 orë/ditë	vjetore
Teatri Kombëtar	1	Punëtor mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
Teatri Kombëtar	1	Biletashitës	4 orë/ditë	vjetore
Galeria Kombëtare e Arteve	1	Vëzhgues/ciceron vizitorë PAK	4 orë/ditë	vjetore
Qendra Kulturorë për Fëmijë	1	Teknik i mesëm	4 orë/ditë	vjetore
Cirku Kombëtar	1	Teknik i mesëm (rrobaqepës)	4 orë/ditë	vjetore
Cirku Kombëtar	1	Teknik i mesëm (marangoz)	4 orë/ditë	vjetore
Cirku Kombëtar	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Cirku Kombëtar	1	Veteriner	4 orë/ditë	vjetore
Cirku Kombëtar	1	Punëtor mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
Muzeu Historik Kombëtar	3	Teknik i mesëm	4 orë/ditë	vjetore
Muzeu Historik Kombëtar	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
Muzeu Historik Kombëtar	1	Punëtor mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
ZAK Butrint	2	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	maj - tetor
ZAK Butrint	3	Punëtor mirëmbajtje	6 orë/ditë	maj - tetor
ZAK Butrint	1	Biletashitës	6 orë/ditë	maj - tetor
ZAK Parku Arkeologjik Apoloni	2	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	maj - tetor
ZAK Parku Arkeologjik Bylis	1	Punëtor mirëmbajtje	6 orë/ditë	maj - tetor
Muzeu i Artit Mesjetar Korçë	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
AQSHF	1	Restaurator	4 orë/ditë	vjetore
AQSHF	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
QRV Artit	5	Restaurator	4 orë/ditë	vjetore
Biblioteka Kombëtare	3	Ndihmësbibliotekar	4 orë/ditë	vjetore
13 Ministria e Shëndetësisë	5			
<i>Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë</i>	2	Operator	6 orë/ditë	vjetore
<i>Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
<i>Qendra Kombëtare e Cilësisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore</i>	1	Operator	6 orë/ditë	vjetore
<i>Qendra e Edukimit në Vazhdim</i>	1	Operator	6 orë/ditë	vjetore
14 Ministria e Drejtësisë	7			
<i>Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror</i>	1	Ftues	6 orë/ditë	vjetore
<i>Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror</i>	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore
<i>Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
<i>Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror</i>	1	Mirëmbajtës	6 orë/ditë	vjetore



	<i>Komiteti Shqiptar i Bërësimeve</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Komiteti Shqiptar i Bërësimeve</i>	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Komiteti Shqiptar i Bërësimeve</i>	1	Operator	6 orë/ditë	vjetore
15	Ministria e Punëve të Jashtme	14			
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	4	Preparatorë	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	3	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Postier	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Lulishtar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	2	Elektracist	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	2	Punonjës ngarkim-shkarkimi	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
16	Ministria e Punëve të Brendshme	120			
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	4	Kuzhinier	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	4	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	30	Kamariet	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	13	Punëtor restoranti	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	1	Teknik	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	6	Receptionist	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	12	Punëtor gjelbërimi	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	10	Punëtor kuzhine	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	25	Punëtor hoteli	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	1	Elektracist	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	1	Hidraulik	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	3	Lavanteri	8 orë/ditë	10.6.2016-10.9.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	4	Punëtor restoranti	8 orë/ditë	01.02.2016-30.4.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	4	Punëtor gjelbërimi	8 orë/ditë	01.02.2016-30.4.2016
	<i>Shtëpia e Pushimit Durrës</i>	2	Punëtor hoteli	8 orë/ditë	01.02.2016-30.4.2016
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	31			
	<i>SHISH (shtëpitë e pushimit)</i>	10	Kuzhinier	8 orë/ditë	qershor-shtator
	<i>SHISH (shtëpitë e pushimit)</i>	4	Banaker	8 orë/ditë	qershor-shtator
	<i>SHISH (shtëpitë e pushimit)</i>	14	Sanitar	8 orë/ditë	qershor-shtator
	<i>SHISH (shtëpitë e pushimit)</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>SHISH (shtëpitë e pushimit)</i>	2	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	38			
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Shërbimit Kombëtar për Rininë</i>	3	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Ajencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë</i>	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë</i>	2	Kujdestar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Shkodër</i>	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Shkodër</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra Polivalente e Përkujdesjes Social Poliqan</i>	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Foshnjës Tiranë</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Fëmijëve Parashkollorë Shkodër</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Tiranë</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Tiranë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Durrës</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, Kamëz</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së</i>	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë</i>	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Fier</i>	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Fier</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Kavajë</i>	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e të Moshuarve Kavajë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Foshnjës Durrës</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Foshnjës Korçë</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Foshnjës Shkodër</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Foshnjës Vlorë</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Shkodër</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Sarandë</i>	1	Mjek pediatër	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Shkodër</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Korçë</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Vlorë</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Qendra e Zhvillimit Berat</i>	1	Mjek i specializuar	4 orë/ditë	vjetore
28	Prokuroria e Përgjithshme	11			
	<i>Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Prokuroria Përmes</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Prokuroria Durrës</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Prokuroria e Apelit Shkodër</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Prokuroria Dibër</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Prokuroria Pukë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Prokuroria Tropojë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Prokuroria Kukës</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore



	<i>Prokuroria Korçë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Prokuroria Mat</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Prokuroria Sarandë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	4			
	<i>Agjencia Telegrafike Shqiptare</i>	2	Specialist - gazetare	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Agjencia Telegrafike Shqiptare</i>	1	Specialist - përkthyes	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Agjencia Telegrafike Shqiptare</i>	1	Fotograf	6 orë/ditë	vjetore
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	1			
	<i>Qendra Kombëtare e Kinematografisë</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
63	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	52			
	<i>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</i>	2	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</i>	10	Specialiste arkivi	8 orë/ditë	dy-muaj
	<i>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</i>	35	Punëtorë	8 orë/ditë	dy-muaj
	<i>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</i>	5	Operatore	8 orë/ditë	dy-muaj
66	Avokati i Popullit	7			
	<i>Avokati i Popullit</i>	7	Specialist	6 orë/ditë	vjetore
77	Autoriteti i Konkurrencës	2			
	<i>Autoriteti i Konkurrencës</i>	1	Specialist arkivist	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Autoriteti i Konkurrencës</i>	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
87	Institucione të tjera qeveritare	4			
	<i>Inspektorati Qendror</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	5.1.2016-31.12.2016
	<i>Inspektorati Qendror</i>	1	Mirëmbajtës	6 orë/ditë	5.1.2016-31.12.2016
	<i>Inspektorati Qendror</i>	1	Punonjës arkiv-protokoll	6 orë/ditë	5.1.2016-31.12.2016
	<i>Agjencia e Prokurimit Publik</i>	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore
88	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile	2			
	<i>Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile</i>	2	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	2			
	<i>Komisioneri</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Komisioneri</i>	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	vjetore
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	37			
	<i>Repartit Inspektim Shpëtim Miniera</i>	6	Teknik emergjence/shpëtimi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Repartit Inspektim Shpëtim Miniera</i>	2	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i MEL-it</i>	2	Roje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i MEL-it</i>	2	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial</i>	2	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial</i>	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Sherbimi Gjeologjik Shqiptar</i>	12	Roje objekti	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Sherbimi Gjeologjik Shqiptar</i>	10	Teknikë gjeologë	6 orë/ditë	vjetore
94	Ministria e Zhvillimit Urban	322			
	<i>Drejtorië Rajonale ALUIZNI</i>	263	Specialistë	8 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtorië Rajonale ALUIZNI</i>	11	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Drejtorië Rajonale ALUIZNI</i>	37	Teknikë të mesëm	8 orë/ditë	vjetore
	<i>Arkivi Qendror Teknik</i>	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Arkivi Qendror Teknik</i>	2	Roje	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit</i>	6	Specialistë	8 orë/ditë	6 muaj
	<i>Aparati i MZHU-së</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i MZHU-së</i>	1	Roje	6 orë/ditë	vjetore
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	1,523			

Lidhja nr. 2

MBI PUNËSIMIN E 200 PRAKTIKANTËVE NË INSTITUCIONET BUXHETORE

Kodi	Emri i institucionit	Numri i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
3	<i>Kryeministria</i>	16	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
4	<i>Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes</i>	9	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
5	<i>Ministria e Buqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave</i>	9	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
6	<i>Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës</i>	14	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
10	<i>Ministria e Financave</i>	12	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
11	<i>Ministria e Arsimit dhe Sportit</i>	9	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
12	<i>Ministria e Kulturës</i>	15	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
13	<i>Ministria e Shëndetësisë</i>	10	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
14	<i>Ministria e Drejtësisë</i>	10	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
15	<i>Ministria e Punëve të Jashtme</i>	3	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
16	<i>Ministria e Punëve të Brendshme</i>	6	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
17	<i>Ministria e Mbrojtjes</i>	5	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
25	<i>Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë</i>	31	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
26	<i>Ministria e Mjedisit</i>	6	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
78	<i>Ministria e Integritimit Evropian</i>	3	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
93	<i>Ministria e Energjetikës dhe Industrisë</i>	18	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
94	<i>Ministria e Zhvillimit Urban</i>	24	Specialist	8 orë/ditë	janar-nëntor
	TOTAL	200			



VENDIM

Nr. 33, datë 20.1.2016

PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve të dhënë në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, i cili organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Spitali e ushtron veprimtarinë në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollat e diagnozës dhe të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

4. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që ofron çdo spital ndahet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore, të ofruara prej tyre.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me metodën:

a) Buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i) paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii) kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii) mallra e shërbime të tjera.

b) Buxhetim global për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të

Këshillit të Ministrave. Buxhetimi global detajohet për çdo spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar në buxhet.

8. Rishpërndarja e buxhetit midis spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3% të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. Një fond jo më i madh se 20 për qind e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për:

a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;

b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda e jashtë vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;

d) pagesa për referime të pacientëve në Spitalin Universitar të Traumës, në zbatim të sistemit të referimit, sipas tarifave të miratuara nga ministri i Shëndetësisë;

dh) pagesa të shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike, nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë sipas legjislacionit për partneritetin publik privat.

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë. Spitalet mund të kryejnë investime, me miratimin e ministrit të Shëndetësisë, edhe nga burime të tjera.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet totalisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, sipas udhëzimit të miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.



12. Ministria e Shëndetësisë, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese (spitaleve), mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra, shërbime e investime.

13. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifrat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë.

14. Mënyra e pagesës dhe e shpërblimit të punës së punonjësve të spitaleve, që kanë lidhur kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas këtij vendimi, përcaktohet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

15. Ministria e Shëndetësisë auditon spitalin, nëpërmjet strukturës së saj audituese, për zbatimin e standardeve të miratuara prej saj, si dhe për mënyrën e përdorimit të buxhetit total të spitalit.

16. Fondi kontrollon dhe monitoron spitalin për buxhetin dhe aktivitetin vjetor sipas kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe.

17. Marrëdhëniet juridike të punës në spitale rregullohen në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

18. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është 12 250 veta, nga të cilët 20 punonjës në Spitalin Universitar të Traumës, për Shërbimin Kombëtar të Urgjencës Mjekësore. Numri dhe struktura e punonjësve për çdo spital miratohet nga ministri i Shëndetësisë.

19. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale e bashkiake, ministri i Shëndetësisë, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë, sipas nevojave. Këta mjekë të specialiteteve të ndryshme, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës “e”, të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

20. Mjekët e kontraktuar sipas pikës 19, të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 9/1, të vendimit

nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.

21. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga ministri i Shëndetësisë. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti i spitalit.

22. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet, nga Ministria e Shëndetësisë.

23. Vendimi nr. 932, datë 27.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2015”, i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë:
 - a) Hemodinamika;
 - b) Reanimacioni i kardiologjisë.
2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;



8. Shërbimi i anestezi-së-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencës së sëmundjeve të brendshme;
10. Shërbimi i mjekësisë interne;
11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë;
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë maksilo-faciale;
19. Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme;
20. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
21. Shërbimi i kirurgjisë digjestive;
22. Shërbimi i urologjisë;
23. Shërbimi i djegie-plastikës;
24. Shërbimi i neurologjisë dhe neurofiziologjisë;
25. Shërbimi i neurokirurgjisë;
26. Shërbimi i onkologjisë+kirurgjia onkologjike:
 - a) Statistika onkologjike (regjistri i kancerit);
 - b) Laboratori histopatologjik onkologjik;
 - c) Laboratori klinik-biokimik onkologjik;
27. Shërbimi i rrezatim-kobaltit;
28. Shërbimi infektiv;
29. Shërbimi i pediatri-së së përgjithshme:
 - a) Urgjenca pediatrike;
 - b) Fizioterapia pediatrike;
30. Shërbimi i pediatri-së së specialiteteve;
31. Shërbimi i pediatri-së infektive;
32. Shërbimi i kirurgjisë infatile;
33. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
34. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
35. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësore, laborator i mjekësisë nukleare);
36. Shërbimi i imazherisë;
37. Shërbimi i fizioterapisë;
38. Shërbimi i statistikave;
39. Shërbimi i pneumologjisë;
40. Kirurgjisë torakale;
41. Shërbimi i ftziatrisë;
42. Shërbimi i gjinekologjisë;
43. Shërbimi i obstetrikës;
44. Shërbimi i patologjisë së barrës;
45. Shërbimi i neonatologjisë;
46. Shërbimi i farmacisë;
47. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatorë;

48. Shërbimi i toksikologjisë;
49. Shërbimi i koordinimit të urgjencave;
50. Shërbimi i psikiatrisë (QSUT);
51. Kontrolli i infeksioneve spitalore.
52. Shërbimi për ekzaminimet e shtrenjta të referuara në zbatim të sistemit të referimit, shërbimi i ortopedisë (protezat) dhe një pjesë e shërbimit të urgjencës (SU Trauma).

II. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të qarkut ofrojnë shërbimet:

1. e urgjencës;
2. e mjekësisë së përgjithshme;
3. e kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologji, urologji, ORL, okulistikë angiologji, max-facial;
4. obstetrikë-gjinekologjisë;
5. neonatologji;
6. pediatri-së;
7. radiologjisë;
8. fizioterapisë;
9. anatomisë dhe histologjisë patologjike;
10. laboratorëve klinikë-biokimike e të mikrobiologjisë;
11. anestezi-reanimacionit;
12. farmacia;
13. shërbimin e onkologjisë, kimioterapisë*, kujdesin paljativ;
14. kontrolli i infeksioneve spitalore;
15. shërbime psikosocial;
16. këshillimit ambulator, për të gjitha specialitetet e mësipërme;
17. banka e gjakut.

III. SPITALET NË NIVEL BASHKIE (RRETHI)

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë shërbimet:

1. e urgjencës;
2. e mjekësisë së përgjithshme;
3. e kirurgjisë së përgjithshme;
4. e pediatri-së dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;
5. e radiologjisë;
6. e laboratorëve klinikë-biokimike e të mikrobiologjisë;

* Trajtimi i kimioterapisë do të jetë në pesë spitale: Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi"



7. e anestezi-reanimacionit;
8. e farmacisë;
9. shërbimin ambulator të specializuar;
10. banka e gjakut.

IV. SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

Shtojca 2

BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2016

000 lekë

Nr	INSTITUCIONI	buxheti					rezerve	total
		600	601	602	604	606		
1	BERAT	213,200	35,600	163,000				411,800
2	BULOQIZË	55,500	9,250	26,600				91,350
3	DELVINË	26,000	4,350	6,000				36,350
4	DEVOLL	34,000	5,650	11,000				50,650
5	DIBËR	199,500	33,300	123,700				356,500
6	ELBASAN	324,000	54,100	246,000				624,100
7	FIER	292,000	48,800	173,900				514,700
8	GRAMSH	86,000	14,450	37,800				138,250
9	GJIROKASTËR	147,700	24,700	86,000				258,400
10	HAS	30,500	5,100	13,000				48,600
11	KAVAJË	88,100	14,700	34,400				137,200
12	KOLONJË	64,200	10,720	22,000				96,920
13	KORÇË	315,600	52,700	188,000				556,300
14	KRUJË	92,800	15,500	26,000				134,300
15	KUÇOVË	45,600	7,600	16,000				69,200
16	KUKËS	174,500	29,100	113,000				316,600
17	KURBIN	58,900	9,800	30,000				98,700
18	LEZHË	176,400	29,500	112,500				318,400
19	LIBRAZHD	102,200	17,100	52,000				171,300
20	LUSHNË	161,700	27,600	107,000				295,700
21	MALËSI E MADHE	13,300	2,250	6,500				22,050
22	MALLAKASTËR	28,000	4,700	11,500				44,200
23	MAT	92,300	15,400	47,500				155,200
24	MIRDITË	72,000	12,000	32,700				116,700
25	PEQIN	26,100	4,350	6,000				36,450
26	PËRMET	63,500	10,600	28,000				102,100
27	POGRADEC	124,400	20,750	76,700				221,850
28	PUKË	67,300	11,250	35,500				114,050
29	SARANDË	107,800	18,000	64,000				189,800
30	SKRAPAR	70,000	11,700	19,500				101,200
31	SHKODËR	380,000	63,470	192,000				635,470
32	TEPELENË	70,300	11,740	20,500				102,540
33	QËSUT	1,691,300	282,450	3,231,000				5,204,750
34	SUOQJ "MBRETËRES HA GERALDINË"	229,100	38,270	250,000				517,370
35	SUOQJ "KOÇO GLIOZHENI"	178,000	29,730	150,000				357,730
36	SU "SHEFOET NDROQI"	212,600	35,500	327,500				575,600
37	TROPOJE	75,900	12,680	34,400				122,980
38	VLORE	311,700	52,050	219,000				582,750
39	SU TRAUMA	9,700	1,620	42,500				53,820
	Paletat e shërbimeve				2,400,000			2,400,000
	Trajtime me VKM				60,000			60,000
	Transferita për individët (mjekë specialistë)					36,000		36,000
	Pagesa të shërbimeve PPP				400,000			400,000
	Rezerve						492,070	492,070
	T OTALI	6,511,700	1,087,530	6,382,700	2,860,000	36,000	492,070	17,370,000



SHTOJCA NR. 3

LISTA E INSTITUCIONEVE QË NUK DO
TË FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Riaftësimit, Mirëritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 98 lekë